

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Shteti duhet të garantojë të drejtën për një zgjedhje të lirë dhe të fshehtë. Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të intensifikojnë përpjekjet për të identifikuar, hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e shitblerjes së votës. Shqipëria duhet të garantojë sigurinë e të dhënave personale të qytetarëve. Ky është epitafi i zi i masakrës elektorale të 25 prillit. Kjo është vula më e errët mbi lirinë dhe demokracinë në këtë vend. E tillë është dhe do të jetë qeverisja që sundon shqiptarët, se sa do të vazhdojë është në dorë të shqiptarëve. Ajo çka sot na prezantohet me zyrtësinë më perverse është paketimi i një bande në formën e qeverisë pa program, pa ide, nuk ka përgjegjshmëri dhe përgjegjësi aq më pak dhimbsuri dhe ndjesi njerëzore për gjendjen kritike ku ndodhet Shqipëria sot. Të grumbulluar nga një dorë e zezë, që veçse e ka shkatërruar ekonominë, ka çuar në depresion familjet shqiptare, ka shpopulluar dhe zbrazur vendin, ka vjedhur, plaçkitur dhe grabitur paratë e shqiptarëve po bëhen gati për gostinë e radhës në trupin e drobitur të shqiptarëve. Kjo është pasqyra më e vërtetë e asaj çka ndodhi më 25 prill, kjo është shija e hidhur e epitaftit të zi që ODIHR-i u vendosi zgjedhjeve të 25 prillit, qëndron aty dhe është i pakapërcyeshëm nga çdo përgjërje për shtrirje dore apo paqeje. Kjo bandë me kollare e jaka të bardha, që po u serviret sot shqiptarëve në formën e qeverisë, nuk ka asnjë lloj lidhjeje me shqiptarët e punës, të djersës së ndershme; është mallkim për studentët, për rininë; është ndëshkim për biznesin e tallje për fermerët; është zeher për pensionistët; agoni e pashpresë për të pamundurit; propozje për ju, minoratë; tallje e radhës për ju, naftëtarë; cinikë, të pashpirt për viktimat e Covid-it dhe krizën ekonomike që pandemia dhe tërmeti ia; ringjallje e maktheve të diktaturës dhe persekucionit politik, vrasar i demokracisë dhe i ligjit.

Për ju kriminelë dhe banda, po, për ju është kjo qeveri. Ju e keni ndërtuar vetë atë. U thirrët nën armë më 25 prill dhe si çakej të babëzitur shqyet votat e shqiptarëve për të kërkuar sot haraçin. Ja ku e keni, të pakeluar e të stolitur! Mjafton një fishkëllimë juaja dhe secili prej kukullave këtu do t'ju bindet. Tashmë e keni rrugën e lirë, më të lirë se kurrë, të pastroni paratë e krimin tuaj e të korrupsionit qeveritar në mes Tiranës. Nuk ka ngelur raport ndërkombëtar pa e pasur kryefjalë, i vetmi që s'bëzan është ai e nuk bëzan, sepse jua ka borxh e ju bën amin. Ju, kriminelë, keni licencë tashmë të vazhdoni të mbillni drogë e kanabis ngado, ju e keni policinë në mbështetje, siç e patët më 25 prill, madje tashmë mund të shpartallonin kufij e dogana me kontenierë bananesh e me drogë e ta shndërroni këtë vend në parajsën e trafikut, siç keni bërë dhe siç raportet ndërkombëtare thonë, se kjo qeveri, ajo që ishte dhe kjo që është ka në fakt drogën dhe krimin program qeveritar, bananen për shqiptarët.

U përgjërta sot Edi Rama se nuk do të mbrojë njeri nga drejtësia, drejtësia tashmë, sipas tij, larg politikës, ndërkohë që servir Ulsiun e dosjes 184, Ahmetajn e inceneratorëve, Ballukun e vjedhjeve të infrastrukturës, Çuçin e tenderëve të uniformës, Xhaçkën e tenderëve të ushqimeve, Ogertën e tenderëve sekretë në mes të zisë së pandemisë. Këta, çuditërisht, janë këtu, në fakt duhet të ishin atje, të jepnin llogari, por i mbron ky, sepse e ka kapur për fyti drejtësinë dhe gjithçka e kanë bërë bashkë, bandë me kollare. Ironia e fatit është se ka vendosur edhe një shtyllë në atë që e quan program qeveritar, "Shqipëria e fortë". Premton tashmë se është ky, je ti Edi Rama, që do të caktosh se kush dhe sa do të jenë gjyqtarë e prokurorë. Por, a duhet të jetë drejtësia e pakapur nga politika? Si ka

mundësi që drejtësisë, sipas teje, tashmë jashtë politikës, i ke vënë në krye Ulsiun, i cili në fjalën e parë që tha sot tregoi se angazhohet të mbarojë, ai, kur do dhe si do, vetingun? Premton Edi Rama Shqipërinë e fortë, duke premtuar se policisë, që e përdori në mbështetje të masakrës zgjedhore, do t'i japë të drejtën të kontrollojë e të përgjojë deri edhe llogaritë bankare. Praktikisht, po u vesh uniformën e patronazhistit këtyre njerëzve dhe pa asnjë droje dhe përgjegjshmëri ministri yt thotë: "Policia e depolitizuar", ajo polici, e cila bënte sehir kur kriminelët e Edi Ramës vidhnin e blinin vota. Premton Edi Rama se do të bëjë ligjin e arbitrazhit? Kalon pa gjë të keqe 110 milionë euro të Beketit me një përgjegjësi penale që do t'i paguajnë shqiptarët. Premton ti se do të hartosh një kod të ri zgjedhor për të rritur luftën ndaj kriminalitetit, ti që i nxore të gjithë kriminelët nga burgu me bekimin tënd e të levave të tua?! Nuk ta ka fajin Kodi Penal për kriminelët që lënë burgjet e dalin në fushatë dhe në kohën e lirë të lirisë, që ti, në fakt, u garanton, mbushin vendin me kanabis e kokainë nga çdo anë e cep.

Nuk ta ka fajin Kodi Penal pse një i dënuar doli nga burgu dhe i mori jetën me bukë në gojë një vajze, një nëne, për ato të cilat mburren e përgjeronesh sot e nuk the vetëm një fjalë. Kjo pra nuk është Shqipëria e fortë, është Shqipëria e të fortëve, në krye të të cilëve qëndron ti. Për ju, patronazhistë, është kjo qeveri, pjesa më me ves e me një trashëgimi të errët të së kaluarës komuniste, përdhosës pa gjak të dinjitetit njerëzor. Turpi e mbuloftë kudo që jeni farën tuaj! Sot skërmitni dhëmbët nga kënaqësia perverse, ja ku e keni produktin tuaj. Për ju, pensionistë e të moshës së tretë, kjo bandë në qeveri harroi, e pranoi edhe në prezantim që ju harroi; për ju në ndihmë ekonomike, çfarë morët në zgjedhje në këmbim të votës? Kaq është ajo se çfarë ju dhuroi kjo qeveri.

Për ju, fermerë, ka shkruar 70 milionë euro, 197 milionë euro të IPARD-it, do të merrni aq sa keni marrë në këta 8 vjet; për ju, biznes i ndershëm, që u dendët në gjoba e në kërcënim më 25 prill, vazhdon mashtrimi progresiv i taksës progresive, për ju zero taksa, por do të keni progresive gjrobat, kontrollet, zhatjen e taksidarëve e të inspektorëve; për ju, arsimtarë, që degdiseni e flakeni pa pikë dinjiteti dhe që ju detyrojnë t'u përdorin në fushatë elektorale, aq sa ju është rritur në 8 vjet aq do t'ju rritet paga; për ju, policë të thjeshtë, nuk ka rritje page, pagat kanë shkuar tek tenderi i uniformave; për ju, mjekë, rritet vetëm 40%, zgjidhni 40% rritje të pagës apo Gjermaninë? Për ju të përndjekur ka vetëm lista fiktive shpërblimi, që do të lexoni nëpër titujt e gazetave, siç ka ndodhur në fakt gjatë 8 vjetëve; për ju që jetoni ende në çadra dhe do të vazhdoni të kaloni dimrat aty, sepse paratë e dëmshpërblimit tuaj shkuan për të blerë votat në Durrës. Për të gjithë fatkeqët që mund t'i zërë Covid-i, jeni në mëshirë të fatit. Do të kuroheni me paratë tuaja, siç edhe ka ndodhur, 3-5 milionë lekë të vjetra për t'u kuruar në shtëpi, pa ndihmë nga shteti. Për ju, minatorë, naftëtarë, metalurgë, nuk ka lekë, ka vetëm një ligj për statusin, të cilit vetëm lëngu mund t'i pihet. Ndërkohë, ka ndodhur një fatkeqësi, një minator është ende nën rrënoja diku në Bulqizë dhe askush nuk thotë gjë për të. Zoti e shpëtoftë atë! Ju, shqiptarë të diasporës, rrini atje ku jeni. Edhe një ministri pa portofol që kishte sa për emër, e hoqi edhe atë.

Tashmë është i zënë në mënyrë të hapur të luftojë kundër shqiptarëve të Kosovës. Ky është programi. Për këtë të gjithë ne do të ndodhemi përballë. Ka vetëm një zgjidhje, ka vetëm një mundësi pakti, me shqiptarët e ndershëm, të djersës, patriotë. Vetëm ky është pakti që do të bëjmë. Ne edhe mund të kemi bërë gabime në të shkuarën. Naiviteti, mirëbesimi, po, pranoj gjithçka, por kurrë nuk kemi bërë as pakt me krimin, as me korrupsionin dhe as i kemi ngulur thika pas shpine Shqipërisë. Ne jemi këtu dhe do të qëndrojmë këtu. Shqiptarët janë të ftuar që së bashku me opozitën, me këtë pjesë të parlamentit, shpresa e vetme për këtë vend, ta çojmë përpara misionin e filluar 30 vjet më parë dhe i lënë përgjysmë. Tani është koha për ta çuar deri në fund. Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe shqiptarët!